

**BLOKOJE URREJTJEN KUNDËR EMIGRANTËVE. SHPËRNDIA SOLIDARITET.**

**BLOKOJE URREJTJEN KUNDËR EMIGRANTËVE. SHPËRNDIA SOLIDARITET.**

**BLOKOJE URREJTJEN KUNDËR EMIGRANTËVE. SHPËRNDIA SOLIDARITET.**

**BLOKOJE URREJTJEN KUNDËR EMIGRANTËVE. SHPËRNDIA SOLIDARITET.**

## URREJTJA ME PAK FJALË



Balkani Perëndimor, ka pasur një numër të madh emigrantësh dhe azilkërkuesish që kanë kaluar përmes rajonit duke u përpjekur për të arritur në BE-në. Kjo rezultoi në emigrantë dhe azilkërkues që ende shpesh në rajon, të rrezikuar nga dhuna dhe abuzimi. Ndërkohë që një pjesë e këtyre grupeve strehohen në hapësira shtetërore, të tjerët varen nga strehimi në nivel lokal. Integrimi në komunitetet pritëse është i komplikuar për shkak të një konteksti socio-ekonomik më të gjërë dhe mungesës së zgjidhjeve të qëndrueshme. Shpeshherë, emigrantët dhe azilkërkuesit shndërrohen në shënjestër të gjuhës së urrejtjes dhe të stigmatizimit.

## URREJTJA NË SHIFRA



Sipas **Indeksit të Gallup për Pranimin e Emigrantëve**, Balkani Perëndimor është ndër **ndër vendet më pak pranuese në botë për emigrantët**. Ky vlerësim, nga Ballkani Perëndimor është qartazi i lidhur - me presionin që ka Evropa në kufijtë e saj të brendshëm/jashtëm që nga viti 2015 dhe krizën pasuese gjatë trajtimit të numrave shumë të mëdhenj të refugjatëve, azilkërkuesve dhe emigrantëve që kanë hyrë në rajon.

### MAQEDONIA E VERIUT

është vendi kryesor më pak pranues, me:

**1.47**

indeks

### MALI I ZI

i dyti më pak, me:

**1.63**

indeks

### SERBIA

renditet e katërta nga fundi me:

**1.80**

indeks

Vendi më pranues në botë është **ISLANDA**, me:

**8.26**

indeks

**Brezat më të rinj janë ata që i pranojnë më lehtë emigrantët në të gjithë botën.**

*"Ndërmjet gushtit dhe fundit të nëntorit 2018, në Bosnje e Hercegovinë u regjistruan **2,554** raste të gjuhës së urrejtjes. Grupet më të shënjestruara ishin refugjatët dhe emigrantët që kalojnë nëpër Bosnje e Hercegovinë rrugës drejt Evropës Perëndimore, të pasuar nga gratë".*

Merdijana Savoviq, Drejtore Rajonale për Ballkanin Perëndimor në Institutin për Raportim në Luftë dhe Paqe me bazë në MB

*"Të dhënat për përvojat traumatike të refugjatëve në Serbi tregojnë se mbi **80%** e tyre kanë përjetuar **gjashtë ose më shumë** përvoja traumatike në vendin e tyre të origjinës para se të niseshin për në Evropë".*

Kryqi i Kuq Serb, raport për shëndetin mendor të refugjatëve dhe emigrantëve

## SFIDAT



*"Kushtet e jetesës në Vuçjak ishin të tmerrshme para se të vinte moti i ftohtë dhe janë bërë edhe më çnjerëzore tani që temperaturat kanë rënë poshtë pikës së ngrirjes. Qenie njerëzore, përfshirë disa të mitur, janë grumbulluar në baltë në një ish-deponi mbeturinash pranë zonave të minierave. Nuk kanë ujë të nrydhshëm dhe kushtet sanitare dhe higjienike janë të rënda. Shumë njerëzve u mungojnë veshjet dhe këpucët e duhura. Është çnjerëzore dhe e papranueshme që t'i mbash njerëzit në kushte të tilla".*

[Dunja Mijatović, Komisionere për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës, lidhur me gjendjen në Kampin Vuçjak \(BeH\), dhjetor 2019](#)

### Gjuha e urrejtjes nuk është liri e shprehjes!

**ECRI rekomandon për Qeveritë e shteteve anëtare që të sigurojnë se të gjithë emigrantët me qëndrim të parregullt – gra, burra dhe fëmijë – të jenë tërësisht të mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit duke vënë në zbatim legjislacionin për këtë qëllim në përputhje me normat dhe instrumentat ndërkombëtarë, përfshirë rekomandimet e politikave të përgjithshme të ECRI.**

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, Rekomandimi Nr. 16 i Politikave të Përgjithshme për mbrojtjen nga diskriminimi i emigrantëve me qëndrim të parregullt

## PËRVOJA PERSONALE



*"Ndoshta një nga hapat më të rëndësishëm që kemi marrë në reagimin tonë ndaj COVID-19 ka qenë angazhimi i refugjatëve dhe emigrantëve brenda qendrës".*

Aref Bandary është mjek dhe ndërmjetësues kulturor me origjinë nga Irani, i cili punon në Komisaratin Serb për Refugjatë dhe Emigrantë (KSRE) në Beograd, Serbi. Ai ka vizituar dhe ka ofruar këshilla për shëndetin publik për refugjatët dhe migrantët pas shpërthimit të pandemisë. (burimi: UNHCR)

*"Jam i vendosur që ta ndërtoj jetën time këtu, ose së paku të përpiqem".*

Raul, një refugjat me origjinë nga Kuba, i cili punon për kompaninë komunale për mbeturina në Podgoricë, Mali i Zi. (burimi: UNHCR)



*"Shqiptarët janë miqësorë dhe na ndihmojnë, si në Siri. Edhe moti është i ngjashëm si në Siri. Tani për tani do të rri këtu, por kur të marrë fund lufta në Siri, dua të kthehem. Mirësi tashmë e di se gjithnjë do të kem dy atdhe: Sirinë dhe Shqipërinë".*

Husam Matwa, një refugjat sirian që është vendosur në Tiranë, Shqipëri dhe ka hapur restorantin e vet.

## PRAKTIKAT E MIRA

◆ **Diaspora boshnjake** në Gjermani është ndër më të mëdhatë dhe përfshin emigrantë që nga koha e luftës, por edhe emigrantë ekonomikë që janë vendosur këtu rishtazi. Në të dyja rastet, emigrantët janë përfshirë në shoqëri, si duke ndjekur studime dhe kualifikime profesionale. Janë zhvilluar organizata të Diasporës në Gjermani dhe janë përhapur edhe OJQ-të, që ndihmojnë me integrimin në nivel lokal.

◆ Mijëra shqiptarë arritën në Itali në vitet 90-të gjatë rënies së regjimit. Deri më sot, në këtë vend janë **430,000** shqiptarë që banojnë në mënyrë të ligjshme në vend, duke u shndërruar në një nga komunitetet më të mëdha. Shqiptarët kontribuojnë në punësim dhe rritje ekonomike dhe në përgjithësi komuniteti është i integruar mirë. Nga viti 2007 deri 2016, shkalla e krimit tek shqiptarët ra me **65%**.

